

1. Cila prej idejave vijuese ka qen e propozuar nga Nills Bori?


A. Elektronet zënë nivele energjetike të caktuara në atom.

B. Bërthama e atomit përmban neutrone dhe protone.

C. Atomi është sferë e fortë që nuk mund të ndahet në pjesë më të vogla.

D. Atomi përbëhet nga ngarkesa negative të vendosura në sferën pozitivisht të elektrizuar.

2. Paraqitja e mëposhtme i përket tabelës së sistemit periodik tek e cila paraqitje është dhënë vendi i një elementi i shenjzuar me X. Sipas kësaj, elementi X është:



A. Element halogjen.

B. Gjysmëmetal(metaloid).

C. Gaz fisnik.

D. Jometal.

3. Në sa shtresa elektronike janë të shpërndarë elektronet në atomin e bariumit ($Z = 56$)?

A. 1

B. 2

C. 5

D. 6

4. Gjithësej, sa palë elektronike të përbashkëta, ka në tre molekula të klorit?

A. 1

B. 3

C. 6

D. 7

5. Acidi palmitik, i cili është pjesë përbërëse e shumë yndyrësive shtazore, ka formulë molekulare $\text{CH}_3(\text{CH}_2)_{14}\text{COOH}$. Cila është formula empirike e tij?

A. CHO

B. $\text{C}_3\text{H}_6\text{O}_2$

C. $\text{C}_8\text{H}_{16}\text{O}$

D. $\text{C}_{16}\text{H}_{32}\text{O}_2$

6. Atomet e bariumit dhe jodit lidhen dhe formojnë komponim jonik. Cila është formula kimike e këtij komponimi?

A. BaI

B. BaI_2

C. Ba_2I

D. Ba_2I_2

7. Metal i panjohur, X, lidhet me azot dhe formon komponimin XN. Metali X njëashtu lidhet me oksigjenin nga çka fitohet komponimi X_2O_3 . Nga cilat elemente të përmendura, mesiguri, është i ndërtuar metali X?

A. ${}_3\text{Li}$

B. ${}_{12}\text{Mg}$

C. ${}_{31}\text{Ga}$

D. ${}_{50}\text{Sn}$

8. Kur gota me ujë të nxehtë, ftohet nga 90°C në 80°C , çka nga të përmendurat ndodh me molekulat e lëngut?

A. Shpejtësia e tyre e lëvizjes zvogëlohet.

B. Elektronet e tyre valente lirohen.

C. Pozitat e tyre bëhen fikse në kristal.

D. Largësia e tyre mesatare nga molekulat e afërta zmadhohet.

9. Cili pohim **më së miri** e përshkruan se çka ndodh kur kloruri i natriumit, NaCl, tretet në ujë?
- A. NaCl reagon me ujin dhe formon NaOH dhe HCl.
B. NaCl reagon me ujin dhe formon NaOH dhe Cl₂.
C. NaCl nuk reagon me ujin, por në tretësirë ekziston në formë të joneve të natriumit dhe joneve klorure.
D. NaCl nuk reagon me ujin, por në tretësirë ekziston në formë të atomeve të natriumit dhe joneve klorure.
10. Pigmenti i bardhë në shumë ngjyra është oksidi i titanit(IV). Ai fitohet gjatë djegies së klorur titanit(IV). Produkti tjetër i këtij reaksioni është klori i gaztë. Cili është barazimi i barazuar i këtij reaksioni?
- A. $TiCl_4 + O_2 = TiO_2 + 2Cl_2$**
B. $2TiCl_4 + O_2 = TiO_2 + 4Cl$
C. $TiCl_4 + 2O_2 = 2TiO_2 + Cl_2$
D. $2TiCl_4 + 2O_2 = 2TiO_2 + Cl_4$
11. Inxhinier ndërton një reflektor diellor i cili patjetër duhet të duron motin e keq, erëra të forta dhe ta reflekton mirë dritën diellore. Ç'farë do të sygjeroje që të përdor?
- A. Metale alkaline.
B. Metale alkaline- tokësore.
C. Metale kalimtare.
D. Gjysmëmetal(metaloid).
12. Emri i komponimit formula e të cilit është MnO₂ është:
- A. Oksid mangani
B. Oksid mangani(I)
C. Oksid mangani(II)
D. Oksid mangani(IV)
13. Nëse vendos copë të pastër të shiritit të magnezit në tretësirë të nitratis të argjendit, magnezi do të shtresohet me substancë të përhimtë. Cili është sqarimi për këtë?
- A. Magnezi reagon me nitratin e argjendit dhe shtresohet me nitratis të magnezit.
B. Argjendi në nitratin e argjendit është në fakt më reaktiv se magnezi, andaj shiriti i magnezit korodohet.
C. Magnezi është më reaktiv se argjendi andaj e dëbon/shtyt argjendin.
D. Magnezi është më pak reaktiv nga argjendi dhe errësohet.
14. Ç'farë të tregojnë emrat për substancat sulfur natrium dhe sulfat natrium?
- A. Sulfur natriumi është i tretshëm në ujë, ndërsa sulfat natriumi nuk është.
B. Sulfat natriumi është shumë i ndezshëm, ndërsa sulfur natriumi nuk është.
C. Sulfur natriumi është i ngurtë, ndërsa sulfat natriumi është gaz në temperaturë të dhomës.
D. Sulfat natriumi ka atome të oksigjenit të lidhura me atome të sulfurit, ndërsa sulfur natriumi nuk ka.
15. Ç'farë vërehet gjatë reaksionit të magnezit dhe acidit klorhidrik ?
- A. Paraqitja e fundërrinës.
B. Paraqitja e fluskave.
C. Paraqitja e dritës.
D. Ndryshimi i ngjyrës.

DETYRA

(Shkruaje përgjigjen në vendin e paraparë)

1. Shkruaj formulat ose emrat e komponimeve vijuese.

Hidrogjenkarbonati i magnezit

$Mg(HCO_3)_2$

Bromur amoni

NH_4Br

Sulfit natriumi

Na_2SO_3

SnO_2

oksid kallaji(IV)

$Na_2CO_3 \cdot 10H_2O$

dekahidrat karbonat natriumi

$Pb(OH)Cl$

hidroksil klorur plumbi(II)

6 pikë (6×1)

2. Për çdonjërin pohim rretho PO nëse është i saktë ose JO nëse nuk është i saktë.

A. Guri i kaltër përmban anjone të bakrit dyvalent.

PO **JO**

B. Tretësira e kripës e cila fitohet gjatë reaksionit në mes acidit dhe bazës është çdoherë neutrale.

PO **JO**

C. Jo çdoherë gjatë reaksionit të metalir dhe acidit fitohet hidrogjen.




PO JO

D. Gjatë titrimit, erlenmaeri duhet vazhdimisht të përzihet.

PO JO


4 pikë (4×1)

3. Mbaroi barazimet kimike dhe barazoi ato.



3 pikë (3 × 1)

4. Në linjën në të djathtë të çdonjërit nocion shkruaje NJË shkronjë duke e pasur parasysh figurën e mëposhtme.



Reaktant **B**

Produkte **E**

Enzim **D**

Komponim i ndërmjetëm **A**

2 pikë (4×0,5)